

**Novobërdë - 10 tetor 2012**



**Komuna e Novobërdës, dhe projekti Zvicër – Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim – LOGOS, organizuan debatin e fundit me qytetarë me temë: Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal**

Në këtë debat morën pjesë Kryetari i Komunës z.Bajrush Ymeri, Koordinator i projektit LOGOS, z. Norbert Pijls, Përfaqësuesja nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë znj.Suzana Goranci,përfaqësues nga Projekti LOGOS,z.Mentor Rexhepi,Konsulenti i jashtëm z.Ismajl Baftiari, Koordinator i Grupeve Punuese z.Skender Avdyli,Përfaqësues nga Policia e Kosovës z.Feriz Bunjaku,anëtarë të grupeve punuese,përfaqësues të partive politike, organizatave dhe shoqatave jo qeveritare, profesorë dhe arsimtarë, afaristë,fermerë, sportistë,përfaqësuese të shoqatave të grave si dhe qytetarë të tjerë.

Kryetari i komunës z.Bajrush Ymeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se ky proces ka filluar para tre viteve dhe jemi munduar të punojmë në mënyrë intensive për të hartuar planet zhvillimore komunale,së pari falënderoj projektin LOGOS dhe qeverinë Zvicerane që na kanë mbështetur financiarisht për të hartuar këto plane zhvillimore,por njëkohësisht falënderoi dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë të cilët vazhdimisht kanë qenë afër nesh.Qytetarë të nderuar fjala në debate çdo herë ka qenë e juaja dhe është ende e juaja,sepse këto plane qe po i bëjmë janë për komunën tonë dhe ende nuk janë aprovuar në kuvend dhe nuk kanë marrë fazën finale dhe ka kohë për ndryshime,plotësime etj,prandaj edhe ky debat i sotshëm ju a jep mundësinë juve që që të jepni ende ide,komente dhe sygjerime.

“Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Novobërdës, është dokumenti më i rëndësishëm i komunës që përcakton kahet e zhvillimit të saj në 10 deri 15 vitet e ardhshme, andaj pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e këtij dokumenti ka një rëndësi të veçantë që Plani Zhvillimor Komunal të jetë në përputhje me interesat e tyre.Dhe pikërisht për këtë,pjesëmarrja dhe kontributi i juaj në debat është me një domethënie të veçantë për të ardhmen e komunës” u shpreh Kryetari z.Ymeri.

Koordinatori i projektit LOGOS, z. Norbert Pijls theksoi se ne tre vitet e fundit kemi punuar së bashku për Planin Zhvillimor Komunal dhe ka qenë proces mjaft elaborues në bashkëpunim me qytetarët,ne kemi pasur takime të rregullta ku e kemi prezantuar punën që është bërë në hapa të ndryshëm, dhe u shpreh i kënaqur rreth punës e cila është bërë deri tani në planin zhvillimor komunal në komunën e Novobërdës.

Përfaqësuesja nga Ministria e Planifikimit Hapsinor znj.Suzana Goranci theksoi se ne kemi përcjellur gjithë procesin e planifikimit të planit zhvillimor komunal,dhe jemi

munduar se si e parasheh dhe ligji për planifikim hapsinor që të ju ofrojmë asistenc dhe këshilla profesionale gjatë hartimit të këtyre planeve,që është shumë më rëndësi për zhvillimin e komunës,si në aspektin socialoekonomik ashtu dhe mjedisor.

Ndërsa Koordinatori i Grupeve Punuese z.Skender Avdyli theksoi se tani më jemi në përfundim për realizimin e këtyre planeve,ku i falenderon gjithë akterët të cilën kanë ndihmuar ecurin e këtyre planeve të rëndësishme për komunë,dhe njëkohësisht bëri prezantimin e punës së Planeve Zhvillimore Komunale që është punuar deri tani. Në këtë takim qytetarët sërish patën rastin që të punojnë në grupet punuese,të shprehim mendimin dhe idet e tyre,me qëllim që të bëhet një plan i kompletuar për komunën e Novobërdës.

I gjithë materiali është i ekspozuar në hyrje të objektit të komunës në katin përdhës dhe në sallën e Asamblesë Komunale, dhe në web faqën e komunës, ku të gjithë të interesuarit janë të lirë dhe kanë mundësinë që vërejtjet,komentet,propozimet dhe idet e ti paraqitni gjatë ditëve të punës e Hëne-Premte duke filluar në ora 08:00-16:00 në fletoren e cila gjendet në këtë sallë deri me datën 18.11.2012.

